



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 1058/prot.  
1

Tiranë më 14.6.2021

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

**MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË**

**Tiranë**

Në vijim të e-mailit tuaj të datës 11.06.2021, sqarojmë se Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”) është shprehur, më parë, nëpërmjet shkresave nr. 1107 prot., datë 28.09.2020 dhe nr. 404/1 prot., datë 05.03.2021, në lidhje me, respektivisht, ligjin nr. 154/2020 “Për regjistrin qendror të llogarive bankare” (në vijim, “Ligji për Regjistrin e Llogarive Bankare”) dhe draftin e mëparshëm të projektvendimit “Për rregullat e aksesit të subjekteve të interesuara në bazën e të dhënave të regjistrit qendror të llogarive bankare”.

Sa më sipër, pa cenuar sa kemi parashtruar në shkresat e mëparshme, lutemi gjeni më poshtë vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për dispozitat e draftit të rishikuar të projektvendimit “Për rregullat e aksesit të subjekteve të interesuara në bazën e të dhënave të regjistrit qendror të llogarive bankare” (në vijim, “Projektvendimi i Rishikuar”), të përcjellë në vëmendjen tonë me anë të e-mailit tuaj të datës 11.06.2021:

- (i) Në lidhje me pikën 2 të kreut I të Projektvendimit të Rishikuar, theksojmë se, bazuar në nenin 6 të Ligjit për Regjistrin e Llogarive Bankare, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) është administruese e regjistrit, ndërsa Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) rezulton të jetë institucioni përgjegjës për krijimin dhe garantimin e masave të sigurisë për të.

Në këtë kontekst, konstatohet se DPT dhe AKSHI janë në cilësinë e bashkëkontrolluesit të regjistrit, por me role të ndara qartësisht në dispozitat e ligjit.

Rrjedhimisht, për të ruajtur këtë kohezion, si dhe për të shmangur çdo interpretim të gabuar që mund të shpjerë në mbivendosje kompetencash, propozojmë që, në fillim të pikës 2 të kreut I të Projektvendimit, të shtohet togfjalëshi si vijon:

*“Në përputhje me nenin 6 të ligjit nr. 154/ 2020 “Për regjistrin qendror të llogarive bankare”;*

- (ii) Në pikën 1 të kreut III të Projektvendimit të Rishikuar parashikohet se subjektet e interesuara, të treguara në geramat a) deri dh) të dispozitës në fjalë, *“[...] kanë akses të plotë, të menjëhershëm dhe të pafiltruar në të dhënat e regjistrit, nëpërmjet përdoruesve të autorizuar prej tyre.”.*

Në vlerësimin e Zyrës së Komisionerit, kjo fjali bie ndesh me parashikimet e nenit 5 të Ligjit për Regjistrin e Llogarive Bankare, i cili i akordon një *akses të plotë, të menjëhershëm dhe të pafiltruar* vetëm Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) – pika 2 e nenit 5 të ligjit në fjalë.

Ndërsa, subjekteve të interesuara të tjera (përfshirë ato të treguara në geramat b) deri dh) të pikës 1 të kreut III të Projektvendimit të Rishikuar) Ligji për Regjistrin e Llogarive Bankare parashikon mundësinë që atyre t’ju jepet akses *“vetëm për ato të dhëna që janë të nevojshme për përmbushjen e detyrave të tyre funksionale sipas legjislacionit të zbatueshëm”* (pika 3 e nenit 5).

Kësisoj, dispozita e sipërpërmendur, me përjashtim të DPPP, kushtëzon nivelin e aksesit në të dhënat e regjistrit nga subjektet e interesuara të tjera në përmbushjen e dy kushteve kumulative:

- a. Kufizimin e numrit të të dhënave – pra, jo akses i plotë;
- b. Përpunimin e të dhënave që janë të nevojshme për përmbushjen e detyrave funksionale – pra, jo akses i pafiltruar.

Sa më sipër, dhënia e aksesit të plotë dhe të pafiltruar, në kundërshtim me dy kushtet kumulative të sanksionuara në pikën 3 të nenit 5 të Ligjit për Regjistrin e Llogarive Bankare, përbën shkelje të parimeve dhe kritereve të përpunimit të të dhënave personale të sanksionuara, respektivisht, në nenet 5 dhe 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar (në vijim, *“Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*).

Theksojmë se pika 4 e nenit 5 të Ligjit për Regjistrin e Llogarive Bankare i rezervon Këshillit të Ministrave të drejtën për të përcaktuar nivelin e aksesit sipas pikës 3 të nenit në fjalë.

Rrjedhimisht, në gjykimin e Zyrës së Komisionerit, pika 3 e nenit 5 të Ligjit për Regjistrin e Llogarive Bankare është e paderogueshme dhe, rrjedhimisht, aksesit nuk mund t’u jepet subjekteve të interesuara, të përmendura në geramat b) deri dh) të pikës 1 të kreut III të Projektvendimit të Rishikuar, në mënyrë të plotë dhe të pafiltruar.

Për këtë arsye, duhet të rishikohet pika 1 të kreut III të Projektvendimit të Rishikuar, në harmoni me dispozitat e nenit 5 të Ligjit për Regjistrin e Llogarive Bankare;

- (iii) Në lidhje me pikën 2, 3 dhe 4 të kreut III të Projektvendimit vlen i njëjti opinion i në pikën (ii) të këtij e-maili;

- (iv) Vlerësojmë se do të ishte e nevojshme të përcaktohej kohëzgjatja e mbajtjes së të dhënave të marra nga regjistri, nga ana e subjekteve të interesuara, si dhe detyrimi për shkatërrimin e tyre në finalizim të përmbushjes së qëllimit të përpunimit nga secili subjekt i interesuar.

Për këtë arsye, pas pikës 8, propozojmë të shtohet një pikë 9 me përmbajtjen si vijon:

*“Subjektet e interesuara i ruajnë të dhënat e mbledhura nga regjistri për aa kohë sa është e nevojshme për përmbushjen e qëllimit të përpunimit të tyre, por në çdo rast, jo më gjatë sesa koha e parashikuar e ruajtjes në përputhje me legjislacionin specifik që rregullon organizimin dhe funksionimin e secilit subjekt të interesuar.*

*Në përfundim të afatit të përpunimit, sipas rastit, të dhënat fshihen, shkatërrohen dhe/ose anonimizohen në mënyrë të pakthyeshme”;*

- (v) Ndalimi i gjurmueshmërisë së aktivitetit të kërkimit dhe përdorimit të regjistrit, i sanksionuar në pikën 9 të kreut IV të Projektvendimit të Rishikuar, mund të rezultojë me pasoja negative, të pakthyeshme, sa i përket garantimit të sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga regjistri.

Për qëllime të garantimit të sigurisë së të dhënave, si dhe parandalimi dhe/ose identifikimit të personave që shkaktojnë cenim të të dhënave (*data breach*), Zyra e Komisionerit vlerëson se duhet të respektohen parimet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), të përcaktuara, ndër të tjera, në udhëzimin nr. 47, datë 14.09.2018, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale *“Për Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 47”*), në harmoni me nenet 27 dhe 28 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në bazë të Udhëzimit nr. 47, çdo kontrollues është i detyruar të krijojë sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale, i cili bazohet në identifikimin, analizimin dhe në zbutjen e rreziqeve ndaj sigurisë së të dhënave personale duke marrë parasysh, ndër të tjera, sistemet TIK për përpunimin e të dhënave, sigurinë fizike të mjediseve, personelit dhe pajisjeve, si dhe përcaktohet në standardet TIK si vijon:

- a. *“Konfidencialitetin”*, duke siguruar që të dhënat personale të jenë të aksesueshme vetëm për personat e autorizuar;
- b. *“Integritetin”*, duke siguruar që të dhënat të jenë të sakta, të plota dhe duke ruajtur metodat e përpunimit të tyre;
- c. *“Disponueshmërinë”*, duke siguruar aksesin e përdoruesit të autorizuar në të dhënat dhe në sistemet e përpunimit;

ç. “Besueshmërinë”, duke garantuar që çdo aktivitet/veprim mbi të dhënat, i sistemeve TIK dhe personelit të përdorur për përpunimin e tyre, është i gjurmueshëm dhe i kontrollueshëm.

Zyra e Komisionerit, me qëllim që të garantohet siguria dhe konfidencialiteti i të dhënave personale, në përputhje me nenet 27 dhe 28 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe Udhëzimi nr. 47 i Komisionerit, vlerësojmë të nevojshme rishikimin e pikës 9 të kreut IV të Projektvendimit të Rishikuar, në përputhje me sa parashtrohet në këtë pikë (v) të këtij e-maili.

Vetëm pas adresimit të plotë të sa pashtuar më sipër, Projektvendimi i Rishikuar do të ishte në përputhje me dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithashtu, nisur nga kompleksiteti i akteve të tilla, si dhe domosdoshmëria për një vlerësim të thelluar dhe korrekt të tyre, lutemi që në të ardhmen projektaktet, që do të përcillni në vëmendje të Zyrës së Komisionerit, të dërgohen zyrtarisht nga titullari i institucionit, si dhe të zbatohen për këtë qëllim afatet e detyrueshme në lidhje me kohën në dispozicion për vlerësimin e përputhshmërisë së tyre me legjislacionin në fuqi.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

